

VENDIM
Nr. 91, datë 9.6.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GAVRAN ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et “GAVRAN 1”, ME FUQI TË INSTALUAR 998 kw DHE “GAVRAN”, ME FUQI TË INSTALUAR 1215 kw, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 2213 kw

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gavran Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.3, gjerat “a”, “b”, 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:
- Paraqitjen e strukturës administrative të shoqërisë (neni 9, pika 2, germa “e”);
 - Paraqitjen e dokumenteve që vërtetojnë mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9, pika 3, germa “c”);
 - Të dhënat për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin (neni 9, pikat 4.1.1 dhe 4.1.2),
 - Shtrirjen e vendit ku do të zhvillohet veprimtaria dhe harta topografike, ku të paraqitet gjurma e linjës transmetuese (neni 9 pika 4.1.3 gjerat “c” dhe “d”) do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gavran 1”, me fuqi 998 kw dhe “Gavran”, me fuqi 1215 kw, me fuqi totale të instaluar 2213 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

